



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:280325

Datë: 01.06.2021

Numri i dokumentit: 01837349

P.nr.304/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashica, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. B. nga Gjilani, për shkak të veprës penale ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 dhe 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1872/19, të datës 27.11.2019, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datat 06.02.2020, 17.06.2020, 16.03.2021 dhe me datën 12.05.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 01.06.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj te akuzuarit S. B. nga babai Xh. dhe nëna H., i lindur me datë 19.09.1986 ne Gjilan, ku dhe jeton, rruga e Kumanovës, i pa martuar, i pa punësuar si punëtor fizik, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPP-ës

REFUZOHET AKUZA

Sepse prej muajit Tetor të vitit 2019 e më tutje të sjelljes se vazhdueshme dhe te padëshirueshme te ngacmimit, i pandehuri S. B. me dashje dhe me qellim te ngacmimit dhe frikësimit përmes rrjeteve sociale Whats App, Facebook dhe Viber, në vazhdimësi i ka dërguar mesazhe dhe e ka thirr përmes telefonit, tani të dëmtuarën B. H, duke e vënë në gjendje shqetësuese me përcjelljen dhe dërgimin e porosive të ndryshme kërcënuese, kështu që i pandehuri me veprimet e tij e shqetëson të dëmtuarën duke i shkaktuar pasiguri, frikë dhe shqetësim të madh emocional

-Me çka kishte për të kryer veprën penale kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës.

-E dëmtuara B. H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 27.11.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1872/19, kundër të akuzuarit S. B. shkak të veprës penale ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 dhe 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.05.2021 prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh pretendimet e të pandehurit që nga fillimi i këtij shqyrtimi se për këtë çështje është gjykuar e po ashtu edhe deklarin e të njëjtit në këtë seancë sikurse edhe krahasimin e mesazheve nga rrjetet sociale sipas lëndës- aktakuzës PP.II.nr 178-20 e datës 18.02.2020 që në përmbajtje janë të njëjta, po ashtu tek aktgjykimi dënues që gjykata e administroj si provë sipas detyrës zyrtare me numër P.nr. 115/20 të datës 05.03.2020 sipas të cilit në dispozitivin e këtij aktgjykimi rezulton se i pandehuri është shpallur fajtor për vepër penale të ngacmimit nga kohë e pa vërtetuar e deri me datë 30.01.2020 dhe duke pasur parasysh se fillimi ose koha e fillimit të kryerjes së veprës penale nuk është përcaktuar ndërsa sipas aktakuzës PP.II.nr.1872/19 të datë 27.11.2019 koha e kryerjes së veprës penale sipas dispozitivit është nga muaji tetor i vitit 2019 e më tutje dhe duke u bazuar këtu konsideron se aktgjykimi dënues i plotfuqishëm e konsumon edhe veprën penale të ngacmimit sipas aktakuzës e cila është objekt i shqyrtimit të sotëm andaj meqenëse roli i prokurorit të shtetit është që ti vlerësoj të gjitha provat qoftë në favor apo në dëm të pandehurit dhe të përkujdeset për to gjatë gjithë procedurës dhe duke i pasur parasysh ato që janë cekur më lartë heq dorë nga kjo aktakuzë.

Andaj meqenëse prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza dhe ndjekja penale pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor gjykata konstaton se duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPP-ës duhet refuzuar aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1872/2019 ndaj të akuzuarit S. B. për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 paragrafi 4 dhe 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë komfor neni 463 paragrafi 3 të KPPK-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1069/19, me datë 01.06.2021

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.